

V E N D I M
Nr.565, datë 7.8.2003

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGORE QAFË MEJDANI-QAFË MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafë Mejdani-Qafë Morinë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 28 203 9 m² tokë/arë dhe 533 copë dru frutorë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 16 373 466 (gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 590 000 (pesëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë.
5. Fondet prej 16 373 466 (gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh, për kompensimin e pronarëve dhe prej 590 (pesëqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh, për shpenzimet procedurale, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.8.2003.
7. Afati i përfundimit të ndërtimeve, që kanë filluar në vitin 2002 të jetë viti 2004.
8. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
FATOS NANO